MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË UJËSJELLËS-KANALIZIMEVE, TIRANË

Raporti Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në ***Drejtorinë e Përgjithshme të Ujësjellës Kanalizimeve Tiranë,*** me objekt:*"Mbi zbatimin e ligjshmërisë, rregullshmërisë dhe vlerësimin e veprimtarisë ekonomiko-financiare, për periudhën 1/10/2010 deri më datën 30/9/2011"* dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 32, datë 09/03/2012. Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23/12/1997 "Për Kontrollin e Lartë të Shtetit", ndryshuar me ligjin nr. 8599, datë 1/6/2000, me shkresën nr. 335/7, datë 09/03/2012 dërguar ***Z. Edmond Hali, Drejtor i Drejtorisë së Përgjithshme të Ujësjellës Kanalizimeve Tiranë***, krahas Raportit Përfundimtar të Auditimit, Kontrolli i Lartë i Shtetit i ka rekomanduar dhe kërkuar zbatimin e masave të mëposhtme:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Nga Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjellës Kanalizimeve, në bashkëpunim me Ministrinë e Punëve Publike të bëhen përmirësimet e duhura të strukturës organizative të institucionit, të miratuar me urdhërin e Kryeministrit nr. 65, datë 6/5/2009, ku:

a) Të përcaktohet kategoria për efekt pagese e pozicionit "kordinator" dhe kategoria për efekt pagese e pozicionit "specialist projekti.

b) Të ngrihet njësia e menaxhimit, monitorimit dhe ndjekjes së kontratave, në përbërje të së cilës të ketë edhe një preventives.

Menjëherë

2. Të merren masa dhe të kërkohet të ribëhen punimet në zërin "Mbushje+ngjeshje në kanal, transhe, banikina me material të imët të përzgjedhur", në vlerën 133,180 lekë, nga sipërmarrësi zbatues i punimeve në objektin për "Rehabilitimin e Puseve Kafaraj" Fier.

Menjëherë

3. Të merren masa dhe të ndiqen procedurat ligjore për të kërkuar rishikimin e vlerës së kontratës së zbatimit të shoqërisë zbatuese për ndërtimin e "Ujësjellësit te Qytetit Kukës dhe të 14 fshatrave të tij". Nga vlera fillestare e kontratës prej 433,325,787 lekë me t.v.sh., të zbritet vlera 2,250,190 lekë, që përfaqësojnë vlerën e disa zërave pune të parashikuara më tepër në preventivin e zbatimit.

Menjëherë

4. Të merren masa dhe të ndiqen procedurat ligjore për të kërkuar rishikimin e vlerës së kontratës së zbatimit të lidhur me shoqërinë zbatuese për "Rehabilitimin e Puseve Kafaraj", Fier. Nga vlera fillestare e kontratës prej 136,691,031 lekë me t.v.sh., të zbritet vlera 6,962,011 lekë, që përfaqëson vlerën e disa zërave pune të parashikuara tepër në preventivin e zbatimit.

Menjëherë

5. Të ndiqen procedurat ligjore për t'i kërkuar firmës ndërtuese shpërblimin e dëmit ekonomik në shumën 4,410,726 lekë me t.v.sh., të kontabilizohet ky detyrim, pasi është përfituar padrejtësisht gjatë zbatimit të punimeve për ndërtimin e "Ujësjellësit Shëngjin, faza e dytë".

Menjëherë

B. <u>MASA PËR SHPËRBLIM DËMI</u>

1. Të merren masa për të kërkuar shpërblimin e dëmit **në vlerën 146,520 lekë**, nga sipërmarrësi [redacted] duke ndjekur të gjitha proçedurat e nevojshme administrative, duke e zbritur në vlerën e situacioneve pasardhëse, si rezultat i raportimit në situacion të punimeve të pakryera, në zbatimin e kontratës me objekt "Rehabilitimi i puseve të Kafarajt, linjat e furnizimit" Fier.

Brenda datës 30/6/2012

<u>Shënim</u>: Auditimi u krye nga audituesit Selime Bicaj Përgjegjëse Grupi, Vladimir Vangjeli, Erjona Leka dhe Ervehe Çumani. Më tej u shqyrtua nga Kryeauditues i Departamentit zj. Luljeta Nano, Drejtori i Departamentit z. Ded Trieshi dhe Drejtore e Drejtorisë Juridike dhe Kontrollit të Cilësisë zj. Elvana Tivari, si dhe u verifikua si praktikë nga Drejtori i Përgjithshëm z. Robert Gjini.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT